

## EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

### **KONKURS – Ekspert lokal afatshkurtër për TIK, në Komponentin 3 (parandalimi i korrupsionit) në projektin Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit**

Punëdhënësi: Agjencia për Integrim European dhe Zhvillim Ekonomik GmbH

Lokacioni: Shkup, Maqedonia e Veriut

Lloji: Angazhim afatshkurtër

Fillimi i pritshëm: Qershor 2021

Kohëzgjatja e pritshme: 20 ditë pune Qershor – Gusht 2021

### **HISTORIA**

Eksperti lokal afatshkurtër në fushën e TIK në Komponentin 3 (parandalimi i korrupsionit) do të punojë si pjesë e ekipit implementues për projektin e mbështetur nga granti i Bashkimit European “Mbështetja e BE-së për Sundimin e Ligjit” në Maqedoninë e Veriut. Projekti zbatohet nga një partneritet ndërkombëtar me përvojë i udhëhequr nga Agjencia për Integrim European dhe Zhvillim Ekonomik GmbH dhe tre bashkë-aplikantë – Ministria e Drejtësisë dhe Administratës e Republikës së Kroacisë, Ministria e Brendshme e Republikës së Austrisë dhe Ludwig Boltzmann Institute i të Drejtave Themelore dhe të Njeriut.

Objektivi i Përgjithshëm i projektit është të forcojë sundimin e ligjit në Maqedoninë e Veriut. Projekti ka katër objektiva specifike: 1. Të përmirësojë kapacitetet e institucioneve të drejtësisë për të siguruar drejtësi në mënyrë transparente dhe të përgjegjshme, 2. Të forcojë kapacitetet për zbatim efektiv të teknikave moderne të hetimit në luftën kundër krimit të organizuar, 3. Të përmirësojë parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit dhe 4. Të përmirësojë mbrojtjen e të drejtave themelore.

Eksperto lokal afatshkurtër në fushën e TIK në fushën e anti korrupsionit (komponenti 3) dp ta mbështesë Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) dhe Drejtuesin e Komponentit për Komponentin 3.

### **DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË**

- Do të zhvillojë instalimin e propozuar dhe fillimin e serverëve të ri në KSHPK
- Cilësimet e migrameve, aplikacioneve dhe bazat e të dhënave nga pajisjet e vjetra në ato të reja
- Konfigurimi i pajisjeve të rrjetit pasiv
- Mbështetje për KSHPK në administrimin dhe menaxhimin e TIK dhe trajnimin mbi mirëmbajtjen e rregullt të sistemit dhe operacionet e përditshme
- Asistencë KSHPK në zhvillimin e Termave të Referencës për KSHPK dhe Komponentin 3 për një tender për zhvillimin e ndërlidhjes me bazat e të dhënave dhe regjistrat e institucioneve të ndryshme publike
- Asistencë Drejtuesit të Komponentit të Komponentit 3 në detyrat e tija

## EU Support for Rule of Law - Republic of North Macedonia

### KËRKESAT

- Rrjedhshmëri në gjuhën angleze, në të shkruar dhe të folur
- Mbi 10 vjet përvojë pune në fushën e TIK
- Përvojë me serverin OS, Ubuntu 20.04, Windows server 2008 dhe 2016
- Përvojë me bazën e të dhënave, Microsoft SQL dhe MySQL
- Shkathtësi të shkëlqyera analitike të dëshmuara me një qasje pragmatike
- Përvojë në punë me institucione të sektorit publik dhe të punësuar në fushën e TIK
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi me gojë dhe me shkrim

### DORËZIMI I APLIKACIONEVE

Aplikacionet duhet të dërgohen në [dragan.kovacevic@aei.at](mailto:dragan.kovacevic@aei.at) (linku dërgon e-mail) deri më 18 qershor 2021, duke shënuar "Local Short-term Expert on ICT" në titullin e email-it (subject line) dhe duke përfshirë një CV të formatit Europass në gjuhën angleze dhe një letër motivuese. Aplikacionet e dërguara pas përfundimit të afatit ose aplikacionet e pakompletuara nuk do të merren parasysh. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në një listë më të ngushtë do të ftohen për një intervistë personale.